



TË DREJTA TË BARABARTA, MUNDËSI TË BARABARTA: ARSIMI DHE AFTËSIA E KUFIZUAR

MATERIALE PËR FUSHATËN 2014

Në Botë rreth 1 miliardë persona jetojnë me aftësi të kufizuar. Ata përballen me një numër të madh pengesash të cilat nuk ju lejojnë që të marrin pjesë në shoqëri. Mohimi i të drejtës për arsim përbën një nga pengesat më të mëdha. Kjo i përjashton ata nga gëzimi i të drejtave të tjera dhe nuk ju lejon të risin potencialet e tyre për të qënë pjesë aktive e shoqërisë.

Rreth 93 milionë fëmijë deri në 14 vjeç jetojnë me aftësi të kufizuar të klasifikuara si të moderuara ose të rënda. Në shumicën e vendeve me të ardhura të ulëta dhe mesatare, fëmijët me aftësi të kufizuar kanë norma të ulta të regjistrimit në shkollë. Edhe në qoftë se fëmijët me aftësi të kufizuar janë në shkollë, krahasuar me fëmijët e tjerë e braktisin shkollën më herët.

Ka fëmijë të cilët e frekuentojnë shkollën, por cilësia e arsimit që ata marrin lë shumë për të dëshiruar. Ata zakonisht janë të detyruar të qëndrojnë në shkolla të segreguara të cilat përbëjnë dhe një ndër faktorët kryesorë për braktisjen e tyre.

Asambleja e Përgjithshme e GCE, duke parë të gjitha vështirësitë që këta fëmijë përballen çdo ditë, vendosi që fushata për arsimin për vitin 2014 do të fokusohet tek aftësia e kufizuar. Kjo fushatë është një mundësi që shoqëria civile, prindër, mësues, të bashkohet për të bërë të mundur që dhe këta fëmijë të gëzojnë të drejtën universal për arsimim.

EQUAL RIGHT

EQUAL OPPORTUNITY

GLOBAL CAMPAIGN FOR
EDUCATION
www.campaignforeducation.org

Education and Disability

Në brendësi

Në këtë paketë do të gjeni:

1. Informacion për arsimin dhe aftësi e kufizuar
2. Qëllimi i fushatës dhe obiekтивat
3. Strategji për ndryshim
4. Kërkesa për politikanët
5. Target
6. Fakte dhe shifra
7. Planifikimi
8. Aktivitetet e fushatës
 - a. Përpara Javës Globale Janar 2014-Maj 2014
 - b. Java Globale 4-10 Maj 2014
 - c. Përtej Javës Globale
9. Materialet për Fushatën
 - a. Të drejta të Barabarta, MUndësi të Brabarta: raport mbi përfshirjen e fëmijëve me AK në sistemin arsimor
 - b. Logot e fushatës dhe fotografi
 - c. Posteri i Fushatës
 - d. Ftesë për lobim
10. Aktivitete online për fushatën
11. Burime për planifikim dhe monitorim

Gjithashtu do të gjeni një paketë për shkollat e cila përmban:

1. informacion për mësuesit
2. Një plan mësimor dhe fletë aktivitetesh
3. Ftesë për përfshirje
4. Pas javës globale
5. Model posterit

1. Informacion për Fushatën

Fushata e re e Global Campaign for Education, Të Drejta të Barabarta, Mundësi të Barabarta: Arsimi dhe Aftësia e Kufizuar ka për qëllim të vejë në dukje problematikat e hasura nga fëmijët me AK në realizimin e të drejtës së tyre për arsimim. Duke nxjerrë në plan të parë përjashtimin nga sistemi arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara, kjo fushatë shpreson që të mbështesë anëtarët e GCE për të ndikuar te qeveritë dhe donatorët që të angazhohen më tepër kundrejt arsimit gjithëpërfshirës.

Njohja e sfidave dhe përballimi i diskriminimit që fëmijët me aftësi të kufizuara përballen cdo ditë përbën një çështje urgjente. Së pari, mohimi i së drejtës për arsim i heq fëmijëve cdo përfitim nga frekuentimi i shkollës dhe gëzimi i të drejtave të tjera si për shembull kufizimi i mundësitë për punësim ose pjesëmarrje në shoqëri. Kjo dhe pengesa të tjera me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara do të thotë se ata janë zakonisht më të varfërit.

Një mungesë e vëmendjes drejtuar arsimit të fëmijëve me AK, është duke ndikuar në arritjen e objektivit të vendosur gjatë Edukimi për të Gjithë dhe Objektivat e Mileniumit për Zhvillim, për garantimin e arsimit fillor për të gjithë. Është e drejtë e cdo fëmije që pavaresisht aftësë se së kufizuar të gëzojë të drejtën për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës. Në vitin 2006, Konventa e OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, vendosi arsimin gjithëpërfshirës si mekanizmin kyc që garanton të drejtën e fëmijëve për arsim. Në një system arsimor gjithëpërfshirës të gjithë fëmijët mësojnë së bashku në të njëjtin komunitet kua ata jetojnë, pavarësisht aftësive të cdo fëmije, dhe duke përdorur metoda mësimdhënie dhe materiale didaktike të njëjta si për vajzat ashtu dhe djemtë.. Krijimi i sistemit arsimor gjithëpërfshirës është shumë i rëndësishëm në cilësinë dhe përmirësimin e sistemit arsimor, garantimin e të drejtave të cdo fëmije me fokus të vecantë në përfshirjen e fëmijëve të shtresave të marginalizuara.

Përkundër këtij angazhimi, përjashtimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara nga sistemi arsimor është shqetësues dhe shumë shtete kanë nevojë që të ndryshojnë legjislacioni përkatës. Edhe në ato raste kur qeveritë kanë politika gjithëpërfshirëse, zbatimi i tyre nëpërmjed politikave, planeve dhe strategjive konkrete lënë shumë për të dëshiruar.

Miratimi i legjislacionit të duhur dhe zhvillimi i politikave dhe planeve kombëtare të veprimit janë shumë të rëndësishëm për të realizuar një arsim gjithëpërfshirës. Del si detyrë parësore që si qeveritë ashtu edhe donatorët të sigurojnë kapacitete dhe burime të përshtatshme për të zbatuar plane ambicioze për një system arsimor gjithëpërfshirës.

Shkollat në vendet në zhvillim nuk janë fizikisht të përshtatshme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përshtatja e shkollave nevojave të fëmijëve me AK është shumë e rëndësishme dhe për këtë arsye cdo qeveri duhet të parashikojnë investime konkrete në këtë drejtim.

Mësues të kualifikuar, të trajnuar për personat me AK janë tepër të rëndësishëm në sigurimin e arsimit cilësor.

Së fundmi, qëndrimet që shoqëria mban kundrejt personave me AK përcakton dhe nivelin e marginalizimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe përjashtimin e tyre nga sistemi arsimor. Qëndrimet negative kundrejt aftësive të fëmijëve me AK i ulin shanset që këta fëmijë të ndiekim shkollën. Ekziston një bindje që opsioni më i mirë për ofrimin e arsimit të fëmijët me AK, janë shkollat special, por kjo gjë nuk garanton integrimin e tyre në shoqëri. Masat që cdo qeveri do të marrë duhet të ndiqen nga fushata sensibilizuese

Cdo qeveri duhet të veprojë mënjëherë për të ndaluar marginalizimin e mëtejshëm të fëmijëve me AK. Duhet të bëhet e qartë se mungesa e arsimit të duhur nuk është faktor që fëmijët të ngelen gjithë jetën të përjashtuar nga një arsim gjithëpërfshirës dhe nga shoqëria që i rrethon.

Sistemi arsimor gjithëpërfshirës i bazuar mbi të drejtat themelore të njeriut duhet të shihet si thelbësore për krijimin e një sistemi arsimor cilësor për të gjithë nxënësit.



Është e drejta e cdo fëmije që pavarësisht

aghtësisë së kufizuar të ketë një arsim të



përshtatshëm

EQUAL RIGHT

EQUAL OPPORTUNITY

Education and Disability

2. Qëllimi dhe Obiektivat e Fushatës

Nëpërmjet fushatës të Javës Globale 2014, kemi për qëllim që të sjellim ndryshime si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Fushata e këtij viti synon të krijojë objektiva lehtësisht të matshëm dhe specifikë.

Qëllimi i Fushatës

Në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar fushata e Javës Globale do të adresojë problematikën e përjashtimit nga sistemi arsimor gjithëpërfshirës të fëmijëve me AK, dhe do të ushtrojë presion mbi politikanët dhe do t'u kërkojë atyre llogari në lidhje me mos realizimin e politikave të arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Obiektivat e Fushatës

Kjo fushatë ka për qëllim të:

1. Të ushtrojë presion për procesin Post-2015 në mënyrë që të ndikojnë në përfshirjen e personave me AK në sistemin arsimor.
2. Të influencojë procesin Post 2015 që të ndajë të dhënat (që janë sipas gjinisë, moshës të ardhurave familjare, lloji i AK dhe tipit të ndihmës mësimore) në mënyrë që të vendosen të tjera objektiva lehtësisht të matshme nga OSHC-të .
3. Të influencojë Partneritetin Global për Arsimin (Global Partnership for Education) për t'u bërë lideri i arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me AK. Kjo nënkupton angazhimin për të sjellë në vëmendje disa nga rekomandimet tonë si p.sh përfshirja e ekspertizës profesionale në mbështetje të procesit të arsimit gjithëpërfshirës.

Nëpërmjet fushatës kombëtare synohet të:

1. Të sigurohet që të paktën 2 qeveri të Evropës Jugore të angazhohen dhe të marrin masa konkrete për të përmirësuar dhe rritur përfshirjen e tyre për arsim gjithëpërfshirës dhe dhënien e fondeve.
2. Të sigurohet që të paktën 2 qeveri të Evropës Jugore të bëjnë plane publike dhe afate konkrete për të implementuar ose financuar angazhimet e më parshme të cilat shërbejnë për të nxitur llogaridhënien dhe transparencën
3. Të influencojë një donator bilateral që të angazhohet në çështjen e aftësisë së kufizuar dhe gjithëpërfshirjes.
4. Në nivel kombëtar aktivitetet e zhvilluara gjatë Javës Globale do të sfidojnë qëndrimet të cilat aktualisht kufizojnë fëmijët me AK për të ndjekur shkollën.
5. Forcimi i kapaciteteve të GCE për të zhvilluar fushatën mbi aftësinë e kufizuar dhe arsimin gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e 20 vendeve të cilat synojnë të sjellin ndryshim.
6. Të ndërtojë bashkëpunim të fortë me të gjitha ato organizata që kanë në fokus aftësinë e kufizuar, organizatat e prindërve me AK dhe GCE.

3. Strategjitë për ndryshim

Strategjia 1

Krijimi i sistemeve të përshtatshme dhe hartimi i planeve kombëtare për gjithëpërfshirjen

Shpesh herë vihet re mangësi në legjislacionin kombëtar, në politikat dhe planet për arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me AK. Hartimi i legjislacionit dhe politikave konkrete janë pika shumë të rëndësishme në sigurimin e gjithëpërfshirjes. Në përgjithësi vihet re një mungesë informacioni nga ana e qeverive për mënyrën se si do të përshtasin standarte ndërkombëtare, si p.sh Neni 24 i Konventës për të Drejtat e Personave me AK, në praktikë. Pak shtete kanë plane ambicioze përsa i përket aftësisë së kufizuar dhe strategjive kombëtare për arsimin gjithëpërfshirës.

Strategjia 2

Sigurim i kapaciteteve, burimet dhe drejtuesit për të implementuar planet kombëtare për gjithëpërfshirjen

Edhe në ato raste kur qeveritë kanë politika dhe legjislacion kombëtar për aftësinë e kufizuar, është provuar që përparimi në këtë drejtim nuk është konkret dhe në përgjithësi zbatimi i ligjeve dhe politikave është provuar të jetë i vështirë. Shpesh herë qeveritë shprehin angazhimin e tyre për sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës, por nuk arrijnë të zbatojnë konkretisht politikat dhe strategjitë. Shume pak vende venë në dispozicion fonde për arsimin gjithëpërfshirës, madje ka raste që këto fonde nuk kanalizohen në mënyrë joefektive. Cdo qeveri dhe Donatorët duhet të rrisin financimet për arsimin gjithëpërfshirës, duke bërë të sigurt që fondet e dhëna të shpenzohen në mënyrën sa më efektive.

Strategjia 3

Përmirësimi i të dhënave mbi aftësinë e kufizuar

Një problem thelbësor që haset në realizimin e të drejtave të personave me AK, në mënyrë të vecantë fëmijët me AK, është mungesa e të dhënave. Në mbarë Botën njohuritë për statusin e përgjithshëm të fëmijëve me AK dhe mundësitë e tyre për arsim gjithëpërfshirës janë shumë të pakta. Vihet re një mungesë e të dhënave të besueshme dhe të qëndrueshme në nivel kombëtar, për pasojë nevojat e fëmijëve me AK për arsimim bëhen të padukshme për politikanët. Për të monitoruar dhe planifikuar në mënyrë efektive, qeveritë duhet të kenë të dhëna të besueshme të cilat do t'i njihojnë ata që të vendosin objektiva të guximshëm dhe realistë.

Strategjia 4

Transformimi i shkollave dhe klasave të përshtatshme për nevojat e të gjithë nxënësve.

Infrastuktura e papërshtatshme që shkollat kanë shpesh herë bëjnë që fëmijët me AK të ngelen të përjashtuar nga ndiekja e shkollave normale. Cdo qeveri duhet të marrë masa konkrete që këto bariera të hiqen dhe të bëhet e mundur paisja e të gjitha shkollave me materialet didaktike të përshtatshme për nevojat e cdo nxënësi.

Strategjia 5

Të sigurohet që ka mjaftueshëm mësues të trajnuar.

Mësuesit janë faktorët kryesorë në përcaktimin e cilësisë së arsimit që nxënësit marrin. Një arsim gjithëpërfshirës i suksesshëm kërkon mësues të përgatitur dhe të trajnuar në mënyrë më të mirë dhe në të njëjtën kohë bashkëpunojnë me specialist të fushës për të siguruar praktikatat më të mira për përfshirjen e fëmijëve me AK në sistemin arsimor.

Ofrimi i mundësive që personat me aftësi të kufizuar të diplomuar për të ushtruar profesionin e mësuesit të ushtrojnë këtë profesion do të bënte të mundur uljen e nivelit të diskriminimit dhe në të njëjtën kohë do t'u ofronte fëmijëve me AK modele shumë të mira suksesi.

Strategjia 6

Sfidimi i sjelljeve që përforcojnë dhe mbështesin diskriminimin.

Sjelljet që shoqëria manifeston kundrejt personave me AK përcaktojnë shkallën e marginalizimit dhe të përfshirjes së tyre në sistemin arsimor. Në rastet kur arsimi ju ofrohet mbizoteron bindja se shkollat special janë më të përshtatshmet për të siguruar arsimin. Por është e nevojshme që të bëhen fushata ndërgjegjësuese.

Strategjia 7

Krijimi i ambienteve të përshtatshme për të mbështetur arsimin gjithëpërfshirës, duke hartuar politika ndër sektoriale dhe strategji që ulin nivelin e përjashtimit.

Është bërë e qatrë që arsimit gjithëpërfshirës i nihmon shkollat në adresimin e nevojave të fëmijëve me AK, por kjo kërkon ndërhyrjen në eliminimin e të gjitha atyre barrierave që pengojnë këta fëmijë të jenë pjesë e sistemit arsimor. Këtu mund të përmendim hartimi i skemave të mbrojtjes sociale ose ndihme në sferën e shëndetit publik.

4. Kërkesat ndaj Politikanëve

Qeveritë duhet të:

Strategjia 1

Të krijojë dispozita ligjore të përshtatshme dhe të hartojë plane ambicioze për gjithëpërfshirjen

- cdo qeveri duhet të ratifikojë dhe të implementojë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.
- të shfuqizojë të gjitha ato pengesa konstitucionale dhe sistemin arsimor.
- të hartojë plane realiste, të përcaktuara në kohë për arsimin gjithëpërfshirës.
- të përfshijë personat me aftësi të kufizuar dhe të gjitha organizatave në monitorimin dhe planifikimin e planeve të arsimit gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet.

Strategjia 2

Të sigurojë kapacitetet, burimet dhe drejtuesit e duhur për të implementuar plane kombëtare afatgjata për arsimin gjithëpërfshirës.

- të paktën 20 % e buxhetit kombëtar t'i dedikohet arsimit dhe të sigurojë që të paktën 50% e tij do të shkojë për arsimin e detyrueshëm.
- të sigurojë një plan specifik për arsimin gjithëpërfshirës me burime të përshtatshme.
- të sigurohet që Ministria e Arsimit mban përgjegjësinë kryesore në garantimin e arsimit të fëmijëve me AK.
- të investojë në ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive të qeverive kombëtare dhe lokale, në mënyrë që që fokusohen më tepër në problematikën e aftësisë së kufizuar.

Strategjia 3

Përditësim i të dhënave për aftësinë e kufizuar dhe pjesëmarrjen e tyre në sistemin arsimor.

- të sigurojë që të dhënat mbi pjesëmarrjen në sistemin arsimor të personave me AK të jenë reale dhe të përditësuara.
- të sigurojë një mbledhje dhe analizim konkret i këtyre të dhënave të cialt do të ndihmojnë në adresimin konkret të nevojave të personave me AK në lidhje me arsimin.

Strategjia 4

T'i bëjnë shkollat dhe klasat të aksesueshme për të gjithë

- Përshtatja e infrastrukturës së shkollave dhe klasave për të gjithë nxënësit pavarësisht aftësisë së tyre.
- të garantojë materiale didaktike dhe teknologjike për të lehtësuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- të garantojë që kurrikula mësimore është e përshtatshme për cdo fëmijë
- hartimi i udhëzuesve kombëtarë për mbështetjen e aftësisë së kufizuar,

Strategjia 5

Të sigurojë që ka mësues të trainuar për arsimimin e fëmijëve me AK

- të ulë raportin mësues-nxënës, në mënyrë që mësuesit të mund të përqendrohen në nevojat individuale të nxënësve.
- të sigurojë trainime të vazhdueshme si para ashtu edhe gjatë karrierës së mësuesve.
- të vendosë në dispozicion të fëmijëve me AK materiale didaktike për të bërë të mundur zhvillimin e aftësisë së secilit nxënës.
- të sigurojë që mësuesit specialë për personat me AK janë burimet kryesore në ndihmë të mësuesve të tjerë.
- të promovojë trainimin dhe dhe rekrutimin e mësuesve me aftësi të kufizuara.

Strategjia 6

Sfidimi i sjelljeve që përforcojnë dhe mbështesin diskriminimin

- të sfidojë të gjitha ato sjellje të cilat i detyrojnë fëmijët me AK të jenë të përjashtuar nga sistemi arsimor duke organizuar fushata ndërgjegjësuese me prinderit, fëmijët, komunitetet, shkollat dhe publikun e gjerë.

Strategjia 7

Krijimi i ambienteve të përshtatshme për të mbështetur arsimin gjithëpërfshirës, duke hartuar politika ndër sektoriale dhe strategji që ulin nivelin e përjashtimit.

- të hartojnë politika të afta për të mbështetur arsimimin e fëmijëve me AK, si p.sh skema të mbrojtjes sociale, programe rehabilitimi, kujdesi shëndetësor i fëmijërisë së hershme etj.

Këto strategji duhet të mbështeten nga doantorë dhe komuniteti ndërkombëtar

Donatorët duhet të:

- të përmbushin angazhimin për të alokuar 0.7% të PBB për ndihmë për personat me AK dhe rreth 10 % të PBB për arsimin e detyrueshëm.
- të sigurohet se ndihma në mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës ose nismat që bëjnë të mundur uljen e rasteve të braktisjes së shkollës nga fëmijët me AK, janë në përputhje me nevojat dhe qëllimet e shprehura.
- të sigurojnë që programet, planet dhe politikat arsimore e bëjnë arsimin gjithëpërfshirës një prioritet.
- të sigurohen që ndihma e dhënë ndihmon në zhvillimin e politikave të cdo qeverie në garantimin e një sistemi arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës.
- të sigurohen që personeli i vënë në dispozicion nga donatorët kanë kapacitetet për të impementuar plane konkrete.
- të forcojnë kapacitetet e qeverive partnere për të adresuar arsimin gjithëpërfshirës.

5. Objektivat politikë

Objektivat që do të meren kë konsideratë gjatë fushatës variojnë nga një vend në tjetrin dhe duke u bazuar në analizeën që cdo koalicion do të bëjë. Cdo koalicion ose anëtar i GCE do të fokusohet në ato institucione ose individë të cilët kanë më tëpër fuqi dhe influencë për të sjellë ndryshim.

Objektivat kryesorë

- Qeveritë kombëtare dhe në mënyrë të vecantë ministrinë e **Financës, Mirëqënies dhe Arsimit** do të jenë objektivat kryesorë në vendet e Evropës Jugore.
- Në ato vende në të cilat janë parashikuar zgjedhje, kandidatët që janë të përfshirë në garën zgjedhore do të ishin objektiv i rëndësishëm në mbështetjen e fushatës.
- Ato koalicione të cilat janë pjesë e Grupeve Lokale të Arsimit mund t'i përdorin ato si mjetin kryesor që do t'i ndihmojë në përsjelljen e mesazheve të fushatës sit e donatorët ashtu edhe tek qeveria dhe ministrinë përkatëse.
- Në ato vende ku ka një prani të theksuar të donatorëve, përfaqësuesit e donatorëve janë një objektiv i rëndësishëm. Në këtë pikë mund të kërkon ndihmën e sekretariatit të GCE në rast se keni nevojë për kontaktet e duhura.
- Në vende donatore, koalicionet duhet të kënë në objektiv qeverive.

Komuniteti Ndërkombëtar duhet të:

- të ndërtojë objektiva globalë të qartë dhe të matshëm për arsimin gjithëpërfshirës në përputhje me axhendën e zhvillimit post-2015.
- të vendosë si prioritet mbledhjen e të dhënave mbi aftësinë e kufizuar dhe pjesëmarrjen e arsim duke bërë të mundur monitorimin e objektivave të vendosur në axhendën e zhvillimit post 2015.
- Prtneriteti Global për Arsimin duhet të bëhet udhëheqësi i sigurimit të arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me AK. Kjo nënkupton sigurimin e ekspertëve më të mirë për të asistuar shtetet në politikat e arsimit gjithëpërfshirës, hartimin e udhëzuesve që do të ndihmojnë në arsimin gjithëpërfshirës etj.

- Qëllimi shumëplanësh që ne duam të vendosim në objektiv është Partneriteti Global për Arsimin (**Global Partnership for Education**). Pas shumë vitesh neglizhencë të temës së aftësisë së kufizuar, tani GPE e ka vendosur atë në fokus primar. Gjithsesi, kjo duhet të shndërrohet në mekanizma konkretë në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me AK.
- Është e rëndësishme për ne që vendosim në objektivin e shënjestrës dhe Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit, të cilat nuk e kanë përfshirë aftësinë e kufizuar në 8 qëllimet, 21 objektivat dhe 60 treguesit në strategjinë e tyre. Në kuadër të axhendës Post 2015 e cila do të zvendësojë Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit, duhet ta përfshijë aftësinë e kufizuar në strategjinë që do të zhvillojë. Për këtë qëllim gjatë 2014 duhet të ushtrohet vazhdimisht presion. Objektivat që do të meren në shënjestër do të jenë: grupi I hapur i punës dhe në Maj takimi global mbi arsimin i UNESCO.

EQUAL RIGHT

EQUAL OPPORTUNITY

Education and Disability

Politikat: angazhimet, zbatimet dhe boshllëqet.

- Që nga Shtatori 2013, 133 vende dhe Bashkimi Evropian kanë ratifikuar Konventën e OKB për Personat me Aftësi të Kufizuar, 23 vende të tjera e kanë firmosur por ende nuk e kanë ratifikuar. Angazhimi për sigurimin e një arsimit gjithëpërfshirës është një detyrim ligjor i cili buron nga Neni 24 i Konventës për Personat me AK.
- Nga një sondazh i bërë në 28 vende, vetëm 10 prej tyre kanë politika konkrete në angazhimin për të përfshirë fëmijët me AK në sistemin arsimor. 13 prej tyre e kanë përmendur aftësinë e kufizuar, por nuk kanë hartuar strategji konkrete ndërsa 5 prej tyre nuk kanë përfshirë fëmijët me AK në politikatat e tyre.
- pjesa më e madhe e shteteve investojnë shumë pak për arsimin gjithëpërfshirës.

- Shpesh dëgjohej të flitet se kostot për të siguruar arsimin gjithëpërfshirës janë të larta, por jo gjithmonë ndodh kështu. P.sh bazuar në një studim kostoja për të përshtatur infrastrukturën e shkollave për nevojat e fëmijëve me AK, rrit vetëm më 1% koston totale të ndërtimit. Një raport i fundit i OECD, parashikon që kostoja e përgjithshme e vendosjes së nxënësve me nevoja të vecanta arsimimi në mjedise të segreguara është 7-9 herë më e lartë sesa regjistrimi i tyre në klasa normale.
- Gjatë një sondazhi i bërë gjatë vitit 2007 tregoi që një pjesë e madhe e mësuesve shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës për shkak të mungesës të trajnimeve profesionale, paisjeve dhe burimeve mësimore.

7. Planifikimi

Elementët kryesorë për planifikimin e fushatës në nivel kombëtar janë:

1. Qartësoni 2-4 kërkesa specifike në të cilat Koalicioni do të fokusohet gjatë fushatës.
2. Identifikimi i objektivave kryesore të cilët do të mund të sjellin ndryshim.
3. Identifikoni aleatët kryesorë, mobilizojini ata gjatë fushatës .Mendoni edhe për donatorët.
4. Hartoni mesazhe të cialt kanë impakt të menjëhershëm dhe që tërheqin vëmendjen.

5. Planifikoni aktivitetet dhe mendoni për mënyrat më efektive për të ndikuar tek objektivat të cilat keni vendosur. Sigurohuni që keni mobilizuar një masë të madhe njerëzish, mundohuni të përfshini deputetë, media të ndryshme në fushatën që do të zhvilloni.
6. Planifikoni dhe materialet të cialt do t'ju nevojiten gjatë zhvillimit të fushatës. Nëse do të keni nevojë për materiale shtesë njoftoni Sekretariatit e GCE për ndihmë.
7. NDANI PLANET TUAJA! Njoftoni GCE për planet tuaja. Vetëm duke ditur palnet tuaja ne mund t'ju ndihmojmë të bashkëpunoni edhe me Koalicionet e tjera, të promovojmë dhe publikojmë kërkesat e fuashatës tuaj.

EQUAL RIGHT

EQUAL OPPORTUNITY

Education and Disability

8. Aktivitetet e Fushatës

Përpara Javës Globale: Janar

2014 - Maj 2014

GCE do të vazhdojë të llojë në nivel ndërkombëtar me objektivat kryesorë organizatat ndërkombëtare.

Në nivel kombëtar anëtarët e GCE janë të ftuar që të paraqesin fushatën në mënyrën më të mirë të mundshme.

Kjo mund të përmbajë:

- Aktivitete të raportuara në median e shkruar, radio, media social etj..
- Të dërgohen kopje të raportimeve të fushatës të objektivat kryesorë politike, aleatëve dhe kontakteve në media, duke specifikuar kërkesat tona.

- Të organizohen takime me Ministrinë e Arsimit dhe atë të Financave për të adresuar dhe marrë masa konkrete në përmbushjen e objektivave të përcaktuar gjatë fushatës..
- Të përfshihen dhe donatorët dhe të inkurajoni ata që të rrisin financimin, të përmirësojnë pilitikat dhe legjislacionin në fuqi për arsimin gjithëpërfshirës.
- të sigurohet përfshirja e meidave të ndryshme gjatë fushatës.
- Të diskutohet me Sindikatat e Arsimit për të përfshirë sa më shumë mësuesit gjatë fushatës në të gjithë vendin.

2 NË SHKOLLA:

1 PËRGATITJE!



Punoni me Sindikatën e Arsimit për të siguruar që dhe mësuesit përfshihen në këtë fushatë.



Ftoni politikanët që të bëhen pjesë e këtij evenimenti



Mblidhni histori nga fëmijë dhe të rritur me AK rreth eksperiencave të tyre në lidhje me arsimin dhe përfshirjen e tyre në të.



Njoftoni median paraprakisht



Ftoni njerës që të vizitojnë shkollat, si p.sh politikanë ose njerës që kanë eksperiencë personale mbi përfshirjen e tyre në arsim.



Mësuesit / nxënësit të tregojnë histori reth mbështetjes që mund t'i kenë bërë personave me AK.



Kërkojini politikanëve që t'u përgjigjen pyetjeve tuaja.



Bëni fotografi dhe i dërgoni ato tek Koalicioni

Java Globale për Arsimin, 4-10 Maj, 2014



Java Globale e GCE i jep mundësi të gjithë lëvizjes dhe aleatëve për t'u mobilizuar në mënyrë të koordinuar në nivel ndërkombëtar, duke bërë që zëri ynë të bëhet më i fuqishëm dhe i aftë të sjellë ndryshim.


Cështja e aftësisë së kufizuar dhe përfshirja e personave me AK në sistemin arsimor shpesh herë është anashkaluar, por për rreth 100 milion fëmijë që kanë një aftësi të kufizuar është tepër e rëndësishme arsimimi.


GCE do të vazhdojë të prodhojë materiale ndërgjegjësuese të cilat trajtojnë çështjet e aftësisë së kufizuar, tregojnë rëndësinë e arsimit gjithëpërfshirës dhe përfshirjen e personave me AK në shoqëri.


Duke përdorur të gjitha informacionet e krijuara nga të gjithë anëtarët e GCE, ne synojmë që t'i tregojmë klasës politike se çfarë ndryshimesh ata janë të aftë të bëjnë.

Inkurajojmë shkollat dhe anëtarët e GCE që të përdorin të gjitha këto burime, dhe të punojnë me personat me AK për të adresuar nevojat e tyre. Në nivel kombëtar, i sygjerohet koalicionëve që të punojnë me një ose më shumë shkolla në kryeqytet dhe të ftojë një person i cili të tregojë mbi eksperiencën pozitive të përfshirjes në sistemin arsimor. Si persona të cilët mund të ftohen po ju sygjerohet: anëtarët e qeverisë, përfaqësuesit e ministrisë së Financave dhe Arsimit dhe të gjithë ata aktorë të cilët ju i konsideroni të rëndësishëm në punën tuaj.


3. KOALICIONET


 Ftoni krerët e qeverisë dhe përfaqësuesit e ministrive përkatës

 Identifikoni folësit potencialë me një histori personale rreth arsimit gjithëpërfshirës.

 Tregoni fuqinë dhe mbështetjen tuaj për këtë çështje.


 Prezantoni kërkesat e fushatës


 Intensifikoni fushatën dhe mediat me fakte, shifra, dhe evenimente.


 Krijoni diskutime, konferenca për shtyp, evenimente kulturore etj.




4 PËRFORCONI

 Publikoni të gjitha premtimet në rrjetin tuaj, dhe në media

 Shkruajini politikanëve të përfshirë letër falenderimi për pjesëmarrjen dhe premtimet e bëra.

 Krijoni një sistem me rrjetin tuaj për të monitoruar atë çfarë është bërë..

 Nëse nuk ka ndonjë zotim, i kërkonte politikanëve pjesëmarrës që t'i shkruajnë ato.

Pas Javës Globale: Maj 2014 e në vazhdim

Kjo fushatë do të vazhdojë angazhimin në nivel global deri në fund të 2014 – ndonëse fushatat në rang kombëtar do të caktojnë afatet e tyre. Është shumë e rëndësishme që presioni të zgjasë.

Antarët e GCE mund të ndërmarrin veprimet e mëposhtme:

- Të bëj publike [do angazhim apo premtim të bërë nëpërmjet mediave kombëtare dhe locale, rrjetit të tyre dhe lëvizjes globale të GCE. Të ofrojnë detajet në gjuhë të ndryshme locale në stacionet locale të komunitetit etj.
- Nëse angazhimet ende nuk kanë mbaruar, bëjë thirrje për angazhime specifike të matshme për të rritur financimindhe politikat që lidhen me arsimin dhe aftësitë e kufizuara deri në fund të 2014.

- Monitoro dhe publiko përgjigjet e qeverisë të bëra gjatë debateve parlamentare dhe diskutimeve të departamenteve qeveritare për cilësinë e arsimit, duke parë nëse ndërhyrjet e tyre reflektojnë angazhimet dhe premtimet e marra nga ata vetë.
- Përdorimi rolin tuaj në [do planifikim zyrtar të sektorit të arsimit dhe profeset e rishikimit (si p.sh. Grupet e Arsimit Lokal) për të provuar vazhdimisht nëse premtimet janë duke u zbatuar përmes planeve dhe buxheteve të qeverisë.
- Përfshini premtimet e bëra në çdo përcjellje të shpenzimeve dhe ofrimit të shërbimit që koalicioni juaj drejton në nivel lokal dhe kombëtar.

Është shumë e rëndësishme, të raportoni aktivitetet tuaja dhe rezultatet e tyre tek GCE. Ne duam që të jemi në gjendje të publikojmë sukseset kombëtare në mënyrë që të mbështesim përpjekjet tuaja advokuese dhe ti kërkojmë qeverisë llogari për premtimet e tyre - ose mungesën e tyre.


Duke na treguar ne se [farë ndodh gjatë Javës tuaj Globale, ne mund t'ja u bëjmë me dije pjesës tjetër të rrjetit duke forcuar kështu fushatat e njeri tjetrit në të gjithë botën.



9. Materiale të fushatës & burimet

Anëtarët e GCE janë të mirëpritur në krijimin e materialeve të përshtatshme për qëllimet e fushatës së tyre. Nëse Sekretariati i GCE mund të ofrojë dosje të tjera për këto qëllime, ju lutemi na bëni me dije se [farë ju nevojiten. Më poshtë gjeni burimet që kemi përgatitur për përdorimin tuaj.

Të gjitha materialet do të mund t'i shkarkoni në: www.campaignforeducation.org



Të Drejta të Barabarta, Mundësi të Barabarta:

Arsim Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Ky raport është publikuar nga GCE me mbështetjen e Handicap International dhe sjell së bashku dëshmi aktuale rreth sfidave, nivelin e përjashtimit nga shkolla të fëmijëve me AK si dhe thekson pengesat që hasin në përfitimin e një sistemi arsimor cilësor. Këtë raport mund ta shkarkoni në Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht, Portugjisht and Arabisht.

Logo e Fushatës


Logo e fushatës është e gatshme në formatin për print dhe ëeb, në të gjitha gjuhët zyrtare të GCE. Logo është në ngjyrën lejla, por ka dhe një version tjetër në ngjyrën e bardhë.

Fotografitë e Fushatës

Fotografitë janë shumë të rëndësishme gjatë fushatës, mundoni të bëni sa më shumë!

Posteritë e Fushatës

Posteritë e fushatës, anëtarët e GCE mund ta shkarikojnë dhe ta përdorin gjatë fushatës së tyre. Posteritë ka përmasën A3 (420mm x 297mm), por mund ta përdorni dhe në formatet A2 A1 dhe A4.



Modeli i letrës për Kryetarin e Shtetit, Ministria e Financës dhe të Arsimit.

Ne ju sugjerojmë ta nisni këtë letër në fillim të vitit dhe po në të njëjtën kohë filloni komunikimin me zyrat e Presidentit/Ministrave për t'i dhënë sa më shumë informacion që të jetë e mundur, në mënyrë që të mund të rrisni shanset e prezencës së tyre.

Fusni logon tuaj Fut kontakt e tua
Vendos
datën

I dashur

E drejtë e Barabartë, Mundësi e Barabartë: Arsim dhe Aftësi e Kufizuar

Në emër të [emir i koalicionit], një koalicion i [nr i organizatave] i organizatave që përfshijnë [insert types / names] dhe një anëtar i Fushatës Globale për Arsimin, po ju shkruajmë që t'ju ftojme për të qenë pjesë e eventit E drejtë e Barabartë, Mundësi e Barabartë, në muajin Maj 2014. Ju ftojmë të na bashkoheni në [rruga] në [date, ora 2014]. Ky event do të jetë pjesë e një seri aktiviteteve që do të ndodhin në të gjithë botën, e cila do të tërheqë vëmendjen për sfidat e thella me të cilat përballen fëmijët me aftësi të kufizuara në realizimin e të drejtës së tyre për arsim.

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë grupi të cilët kanë më pak të ngjarë të realizojnë të drejtën e tyre për një arsim cilësor, pavarësisht objektivave globalisht të miratuara e të përcaktuara për Arsimin për të Gjithë në Qëllimet për Zhvillim të Mijëvjeçarit. Në Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 2006 për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD), themeluan arsimin gjithëpërfshirës si mekanizmi kyq për të dhënë të drejtën për arsim fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në [emir i vendit], qeveria juaj ka bërë përparim të madh në [fusni p.sh progresin e bërë], por që sigurisht ka ende sfida për tu përballuar [vendosni sfidat]. Si një koalicion i shoqërisë civile, ne duam të punojmë me qeverinë tuaj për të përmbushur këto sfida.

Eventi i datës [data...] do të ofrojë një mundësi për ju për të deklaruar qëndrimin e qeverisë tuaj dhe të tregojë përpjekjet që po bëni për të siguruar që [vendi] po punon për të ofruar një arsim cilësor për [do fëmijë, pavarësisht kufizimeve në aftësi. Në mënyrë të veçantë, ju ftojmë për të visituar [emrin e shkollës] dhe të ndiqni një orë mësimi me fëmijët e [klasa] dhe mësuesit e tyre, në prani të përfaqësuesve kombëtarë të shoqërisë civile dhe medias kombëtare. Fëmijët do të flasin për rëndësinë e sistemit arsimor gjithëpërfshirës dhe ne ju ftojmë që të përshkruani veprimet e qeverisë tuaj për këtë [është vendimtare.

Ne do të ndiheshim të nderuar nga prezenca juaj në këtë event dhe do të vlerësojmë një konfirmim nga zyra juaj deri në [datë], me qëllim që të ndërmarrim veprimet e duhura. Ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni nëse keni pyetje të tjera.

I juaji sinqerisht,
[vendosni
pjesëmarësit]

10. Aktivitetet Online të Fushatës

Rrjetet sociale: Facebook & Tëitter

Mbi një milion njerëz e kanë mbështetur më parë fushatën online të GCE, duke firmosur peticione online, duke u bashkuar me ne në Facebook, duke targetuar figura politike në Tëitter apo duke shkruar rreth fushatës nëpër ëbsitet apo blogjet e tyre.

Në shkallë ndërkombëtare, GCE do të prezantojë aktivitete online për të inkurajuar pjesëmarrje maksimale nga mësuesit, shkollat dhe anëtarë të publikut.

GCE do të udhëheq një seri aktivitetimesh për fushatën në të dyja rrjetet sociale më sipër, nga llogaritë tona ndërkombëtare.

www.facebook.com/campaignforeducation

www.twitter.com/globaleducation

Website i Fushatës: www.campaignforeducation.org

Në website të GCE, ju mund të:

- Regjistroni dhe promovoni aktivitetet tuaja si anëtar i GCE ose si një institucion arsimor
- Ngarkoni artikujt tuaj të lajmeve.
- Ngarkoni imazhet nga eventet e fushatës tuaj gjatë gjithë vitit
- Shkarko materiale dhe burime të tjera sic janë postera, logo dhe raportet e fushatës.

Gjithashtu edhe duke postuar rregullisht mbi [ështjen e aftësisë së kufizuar duke përdorur këto profile, do të ketë edhe një seri mesazhesh në dispozicion të ëbsite të fushatës të cilat mund të shpërndahen menjëherë në të dyja këto rrjete vetëm duke klikuar mbi një link.

Ne do i kërkojmë të gjithë anëtarëve të GCE që kanë profile në Facebook dhe/ose Tëitter të na bëjnë me dije emrat e profileve të tyre me qëllim që ne të rrisim forcën dhe influencën tonë kolektive në këto rrj

E-fushata

GCE do të dërgojë emaille në databazën e mbështetësve tanë publikë që t'i inkurajojë ata për t'ju bashkuar fushatave të tyre kombëtare në vendin që ata jetojnë, ose të nënshkruajnë letrën globale. Ne inkurajojmë fuqimisht anëtarët e GCE që të dërgojnë të njëjtët mesazhe në databazat tuaja kombëtare dhe ndërkombëtare të E-fushatës në vendet e tyre.

Blogu GCE: blog.campaignforeducation.org

GCE ka blogun e vet ku anëtarët janë të mirëpritur të paraqesin artikujt e tyre dhe të marrin pjesë në diskutime online. Gjatë 2014, ne po i kërkojmë anëtarëve të dërgojnë artikuj që paraqesin të gjithë aspektet e punës së tyre, por në veçanti mbi [ështjen e aftësisë së kufizuar. Ne jemi shumë të prirur për të ekspozuar realitetin për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe që të jemi në gjendje që ta bëjmë këtë është jetike që të kemi informacione nga anëtarët.



